



GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E FAMILJEVE NË SHQIPËRI

Gjashtëmuji i parë 2023

**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

Gusht 2023

PERMBAJTJA

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit	3
1- Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar	4
2- Huamarrja e familjeve	6
3- Ngarkesa në borxh e familjeve	11
4- Pasuria e familjeve	13

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit

Nga rezultatet e vrojtimit vihet re se totali i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar rënie gjatë periudhës. Në terma vjetorë, rënia ka ardhur nga të tre sektorët, por më e theksuar në sektorin shtetëror. Pësha e familjeve huamarrëse ndaj totalit dhe teprica e huasë së deklaruar kanë rezultuar në rritje në terma vjetorë. Pjesa më e madhe e huamarrjes ka për qëllim zhvillimin e një biznesi dhe blerjen/riparimin e një prone. Familjet shfaqen më optimiste lidhur me aftësinë së tyre paguese në gjashtë muajt e ardhshëm, ndërsa kërkesa për huamarrje pritet të tkurret, ndikuar nga rritja e normave të interesit.

▪ GJENDJA FINANCIARE

Numri total i të punësuarve ka shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Në terma vjetorë, rënia ka ardhur kryesisht nga sektori shtetëror dhe sektori i të vetpunësuarve. Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve ka shënuar rritje si në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, por rritja e shpenzimeve ka qenë më e theksuar.

▪ HUAMARRJA

Rreth 24% e familjeve të përgjigjura (ose 256 familje), deklarojnë se kanë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje. Kjo peshë ka rënë me 1pp në terma gjashtëmujorë dhe është rritur me 2 pp në terma vjetorë. *Totali i tepricës së raportuar të huasë, ka rezultuar në rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.* Rreth 64% e tepricës është siguruar nga 'burime formale' ('bankat' dhe 'IFJB) dhe 36% nga 'burime joformale' ('persona fizikë' dhe 'hua në formë malli') dhe kjo strukturë është zhvendosur në favor të huamarrjes nga burime formale, si rezultat i rritjes së vlerës së huamarrjes nga bankat. Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 25% e huasë është përdorur për 'blerjen/riparimin e një prone'; 53% për 'zhvillimin e një biznesi'; 4% për qëllime 'konsumi'; dhe 20% për 'qëllime të tjera'.

▪ NGARKESA NË BORXH

Rreth 65% e familjeve huamarrëse të përgjigjura deklarojnë që kësti i huasë nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për rritje të tij, ndikuar nga rritja e normave të interesit në vend. Për gjashtëmujorin e dytë 2023, rreth 65% e familjeve nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve sugjeron për pritje më optimiste krahasuar me rezultatet e dy periudhave të kaluara. Indeksi i marrjes/rimarrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm ka shënuar rënie në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, duke sinjalizuar ngadalësim të mëtejshëm të kërkesës së individëve për financim.

▪ PASURIA E FAMILJEVE

Rreth 92% e familjeve (total i kampionit të intervistuar) 'zotërojnë 1-2 prona të patundshme', kryesisht shtëpi banimi. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe ka shënuar rënie me 1pp krahasuar me një vit më parë; 3% deklarojnë se 'zotërojnë më shumë se 2 prona të patundshme', (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.) dhe 5% kanë deklaruar se 'nuk zotërojnë asnjë pronë'. Në grupin e familjeve që deklarojnë pasuri financiare, rezultojnë se depozitat dhe/ose llogaritë bankare vijojnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të familjeve (51% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (50% e rasteve të raportuara). Të dyja këto pësha kanë shënuar rënie në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë.


1- Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar

Karakteristikat e kampionit. Vrojtimi i radhës është kryer mbi kampionin rastësor prej 1203 familjesh, ku rreth 88% e tyre (1055 familje) kanë marrë pjesë në procesin e intervistimit duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Pësia e të përgjigurve ndaj totalit të kampionit është rritur me 1 pp krahasuar me vërtetimin e kaluar dhe me 2 pp krahasuar me një vit më parë. Në totalin e familjeve të përgjigjura, rezultoi se rreth 56% e tyre banojnë në zonat urbane dhe 47% në zonat rurale të vendit.

Analiza në vijim i referohet vetëm familjeve që kanë dhënë përgjigje për secilën pyetje dhe të gjitha llogaritjet janë bërë mbi bazën e totalit të të përgjigurve.

1.1-Punësimi dhe burime të tjera të ardhurash. Numri total i anëtarëve të familjeve që sigurojnë të ardhura nga punësimi/vetëpunësimi në sektor shtetëror, privat dhe/ose burime të tjera¹, ka shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (me 0.7%) dhe krahasuar me një vit më parë (me 2.2%), më e theksuar në rastin e të punësuarve në sektorin shtetëror dhe të atyre që përfitojnë asistencë sociale. Nga ana tjetër, numri i atyre që sigurojnë të ardhura nga emigracioni ka shënuar një rritje me 17.6% krahasuar me një vit më parë.

Grafik 1.1 Shpërndarja e personave që sigurojnë të ardhura sipas llojit të burimit
(në % ndaj totalit të personave që sigurojnë të ardhura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zëri "Tjetër" përmbledh kryesisht rastet e personave që marrin asistencë invaliditeti, ndihmë nga të afërm dhe ata që bëjnë punë të rastit.

Duke e fokusuar analizën vetëm në pjesën e të punësuarve² të kampionit të vërtetuar (Tabelë 1.1), numri total i tyre ka shënuar rënie me 1.2% në terma gjashtëmujorë dhe me 4.5% në terma vjetorë. Në terma vjetorë, rënia ka ardhur nga të tre sektorët, por më e theksuar në sektorin shtetëror (me 16%).

¹Në pyetësor, përveç punësimit në sektorët shtetëror dhe privat, si burime të ardhurash listohen dhe: "pensioni", "asistenca sociale për papunësi", "emigracioni" dhe zëri "tjetër", ku përfshihet çdo lloj burimi tjetër që nuk është marrë parasysh në alternativat e dhëna.

²Këtu janë përfshirë vetëm të punësuarit në sektorët shtetëror, privat (bujqësor dhe jobujqësor) dhe të vetëpunësuar (në sektor bujqësor dhe jobujqësor).

Tabelë 1.1 Numri i të punësuarve sipas sektorëve

		Shtetëror	Privat	Vetëpunësuar	Total të punësuar	Ndr. 6-mujor	Ndr. vjetor
V20	6MI_2020	233 (16%)	621 (43%)	585 (41%)	1439	1.7%	-4.2%
V21	6MII_2020	234 (16%)	578 (41%)	611 (43%)	1423	-1.1%	0.6%
V22	6MI_2021	241 (17%)	670 (46%)	532 (37%)	1443	1.4%	0.3%
V23	6MII_2021	231 (16%)	642 (44%)	602 (41%)	1475	2.2%	3.7%
V24	6MI_2022	234 (16%)	639 (45%)	550 (39%)	1423	-3.5%	-1.4%
V25	6MII_2022	197 (14%)	679 (49%)	499 (36%)	1375	-3.4%	-6.8%
V26	6MI_2023	196 (14%)	635 (47%)	528 (39%)	1359	-1.2%	-4.5%


Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Shënim: Shifrat në kllapa janë peshat e secilit zë në raport me totalin e të punësuarve.

Numri i familjeve që kanë deklaruar dhe **burime të tjera të qëndrueshme të ardhurash**³ (si qira, interesa bankare etj.) ka rezultuar 13% (ose gjithsej 135 familje), duke shënuar një rritje të lehtë me rreth 1 pp gjatë periudhës krahasuar me një vit më parë. Në këtë grup familjesh, rreth 64% e tyre deklarojnë si burime alternative të ardhurash *'interesat nga kursimet (depozita, bono thesari etj.)*, ndërsa rreth 23% deklarojnë të ardhura nga *'qiradhënia e pronave'*. Të dy këta zëra kanë shënuar rritje si në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Një peshë të konsiderueshme (rreth 10%) ka vijuar të shënojë zëri "tjetër", ku familjet përmendin si burim të ardhurash kryesisht ndihmën nga familjarë ose të afërm.


1.2-Të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve. Gjatë 6-mujorit në analizë, pjesa më e madhe e familjeve (rreth 45%) vijojnë të deklarojnë të ardhura mujore në nivelin "17-50 mijë lekë", por kjo peshë ka rënë me 2 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 7 pp krahasuar me një vit më parë (Grafik 1.2). Nga ana tjetër, struktura e shpërndarjes së familjeve sipas *nivelit të të ardhurave mujore*, duket se ka vijuar të zhvendoset drejt niveleve më të larta si "50-100 mijë" (34% të familjeve) dhe "100-200 mijë (12% e familjeve).

Grafik 1.2 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 1.3 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të shpenzimeve




Në shpërndarjen e familjeve sipas nivelit të *shpenzimeve të domosdoshme të jetesës*, gjatë periudhës vihet re që struktura ka vijuar të zhvendoset drejt dy niveleve më të larta të shpenzimeve mujore ("50 mijë-10 mijë lekë" dhe "mbi 100 lekë në muaj"), duke reflektuar në këtë mënyrë rritjen e kostos së jetesës së familjeve për shkak të rritjes së çmimeve në vend (Grafik 1.3).

³ Në këtë pyetje, alternativat e listuara si burime të qëndrueshme të ardhurash janë: (1) qira, (2) interesa nga kursimet (depozita, bono thesari etj.), (3) interesa nga para të dhëna hua të tretëve, (4) tjetër (përcakto).

Në bazë të përgjigjeve të mësipërme, rezulton se **Indeksi i të ardhurave**⁴ dhe **Indeksi i shpenzimeve**⁵ kanë **shënuar rritje gjatë periudhës**, por rritja e indeksit të shpenzimeve ka qenë më e lartë se rritja e indeksit të të ardhurave.

Grafik 1.4 Indekset e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve (2010=100)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Euroizimi i të ardhurave të familjeve shqiptare vijon të mbetet i ulët, ndonëse me prirje rritëse. Kështu rreth 21% familjeve (220 familje nga 1055 familje të përgjigjura) deklarojnë se kanë të ardhura në valutë (kryesisht në euro) në raporte të ndryshme ndaj totalit të të ardhurave mujore⁶. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe është rritur me 3.6 pp krahasuar me një vit më parë.

2- Huamarrja e familjeve

Në këtë vrojtim, numri i familjeve që deklarojnë se kanë *një ose më shumë hua për të paguar* në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje, ka rezultuar në *256 familje ose rreth 24% e të përgjigjurve*. Kjo peshë ka rezultuar në rënie me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe në rritje me 2 pp krahasuar me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 27%. *Analiza në vijim i referohet vetëm grupit të familjeve huamarrëse*⁷.

⁴ "Indeksi i të ardhurave" është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientet e përcaktuar për çdo interval si në vijim: "deri në 17 mijë lekë" me 0.2; "17-50 mijë lekë" me 0.4; "50-100 mijë lekë" me 0.6; "100-200 mijë lekë" me 0.8; dhe "mbi 200 mijë lekë me 1". Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të të ardhurave mujore.


⁵ 'Indeksi i shpenzimeve' është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: "deri në 10 mijë lekë" me 0.2; "10-20 mijë lekë" me 0.4; "20-50 mijë lekë me 0.6"; "50-100 mijë lekë me 0.8" dhe "mbi 100 mijë lekë" me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 =100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të shpenzimeve të domosdoshme mujore.

⁶ Alternativat që lidhen me nivelin e të ardhurave në monedha të huaj janë: (1)"nuk kam fare", (2) "deri ne 10%", (3)"10-50%" dhe (4)"mbi 50%".

⁷ Shënim metodologjik: meqë një familje mund të ketë më shumë se një hua për të paguar me karakteristika të ndryshme (burimi, qëllimi etj), për të mos humbur informacionin, në këtë rubrikë, llogaritjet janë bërë mbi "totalin e rasteve të huamarrjes" të deklaruar, përveçse kur specifikohet "...mbi totalin e huamarrësve (në këtë vrojtim = 257 familje). Me "raste huamarrje" nënkuptojmë totalin e huave të marra nga e njëjta familje dhe me të njëjtën karakteristikë, p.sh.: një familje që deklaron 2 hua të marra nga banka përbën "1 rast huamarrje nga banka" dhe një familje që ka një hua nga banka dhe një nga një person fizik, përbën "1 rast huamarrje nga banka" dhe "1 rast huamarrje nga persona fizik".


2.1-Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse. Gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar, struktura e shpërndarjes së familjeve huamarrëse sipas të ardhurave/shpenzimeve është zhvendosur drejt niveleve më të larta të të ardhurave dhe shpenzimeve, krahasuar me periudhën e kaluar, por disi më e theksuar në kahun e shpenzimeve. Kjo zhvendosje ka sjellë rënie të indeksit të të ardhurave dhe rritje të indeksit të shpenzimeve, (Grafik 2.2), gjë që nënkupton prirje në përkeqësim të situatës financiare të familjeve huamarrëse.

Grafik 2.1 Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes huamarrëse
(2010 = 100)



2.2-Qëllimi i huamarrjes. Qëllimi kryesor i huamarrjes mbetet: “për konsum” në 37% të rasteve të huamarrjes, “për blerjen/riparimin e një prone” në 17% të rasteve dhe për “zhvillim biznesi” në 15% të rasteve. Pesha e rasteve të huamarrjes për “për blerje/riparim prone”, ka shënuar rënie me 3 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 7 pp në terma vjetorë, ndërsa pesha e rasteve për “zhvillim biznesi” ka shënuar rritje me 4 pp gjatë periudhës dhe ka mbetur e pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, pesha e rasteve të huamarrjes për “konsum” ka rezultuar në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (me 1 pp) dhe krahasuar me një vit më parë (me 5 pp), gjë që mund të jetë ndikuar dhe nga rritja e kostos së jetesës së familjeve për shkak të rritjes së çmimeve në vend.


Grafik 2.2 Huamarrja sipas qëllimit të përdorimit të huasë
(në % ndaj totali të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


2.3-Teprica e huasë. Duke analizuar tepricën e deklaruar sipas burimeve dhe qëllimeve të përdorimit, rezultoi se për gjashtëmujorin në analizë, rreth 64% e tepricës vjen nga burime formale, në masën më të madhe nga bankat dhe rreth 36% nga burime joformale, (32% në formën e huamarrjes nga “persona fizikë” dhe 4% si “hua në formë malli të papaguar”). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, kjo strukturë është zhvendosur (me 16 pp) në favor të huamarrjes nga burime formale kundrejt asaj joformale, si rezultat i rritjes më të madhe të vlerës së huamarrjes nga bankat, kundrejt rritjes së huamarrjes nga personat fizikë dhe huamarrjes në formën e mallit të papaguar (Grafik 2.3).

Grafik 2.3 Përbërja e tepricës sipas burimit të huasë (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 2.4 Përbërja e tepricës sipas qëllimit të huasë. (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim. Zëri “Të tjera” përfshin kryesisht huamarrje për të përballuar shpenzime mjekësore.

Duke e analizuar tepricën e huamarrjes sipas qëllimit të përdorimit (Grafik 2.4), rezultoi se rreth 23% e saj është përdorur për “blerjen/riparimin e një prone” (17 pp rënie në terma gjashtëmujorë dhe 18 pp në terma vjetorë); 53% për “zhvillim biznesi” (në rritje respektivisht me 28 pp dhe 42 pp si në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë) dhe 4% për “konsum” (rritje me 1 pp respektivisht krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe në rënie me 5 pp krahasuar me një vit më parë). Një peshë të konsiderueshme vijon të ketë huamarrja për “qëllime të tjera” (rreth 20% e tepricës), ku mbizotëron huamarrja për mbulimin e “shpenzimeve shëndetësore”. Ky zë ka rezultuar në rënie me 12 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 19 pp në terma vjetorë.

2.4-Format e huamarrjes. Në rreth 37% të rasteve të raportuara, huamarrja e familjeve rezultoi në formën e “kredisë nga institucione financiare”, ku 32% e rasteve janë në trajtë “kredie bankare” (rritje me 4 pp krahasuar me 6MII 2022 dhe rritje me 1 pp krahasuar me një vit më parë) dhe 4% janë në trajtë “kartash krediti dhe overdraft” (rënie me 3 pp krahasuar me 6MII 2022 dhe rritje me 1 pp referuar një viti më parë). Në rreth 43% të rasteve, huamarrja deklarohet në formën e “parasë në dorë” dhe në 20% të rasteve në formë “malli të papaguar”. Në rastin e parë, peshat kanë rezultuar në rënie si në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë, ndërsa në rastin e dytë ato kanë qenë në rritje veçanërisht në terma vjetorë.


Grafik 2.5 - Huamarrja sipas formës së huasë
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.5-Pagesa e huasë. Dy format kryesore të pagesës së huasë vijojnë të mbeten pagesat “me shumë të njëjtë çdo 1/3/6/12 muaj” (47% e rasteve të huamarrjes), “me shumë të ndryshueshme në periudha të ndryshme” (31% e rasteve të huamarrjes) dhe me “shuma të ndryshueshme çdo 1/3/6/12 muaj” (10% e rasteve të huamarrjes). Gjatë gjashtëmujorit në analizë, vihet re një rritje (respektivisht me 7 pp dhe 8 pp) e peshës së huamarrjes që paguhet rregullisht me shumë të njëjta (ose të ndryshueshme) çdo muaj, tipike e kredimarrjes bankare afatgjatë (si p.sh. kredimarrja për blerje shtëpie ose zhvillim biznesi). Nga ana tjetër, peshat e rasteve të huamarrjes që shlyhet me “një shumë në fund të periudhës” dhe me “shuma të ndryshme në periudha të ndryshme”, karakteristikë e huave joformale apo huave bankare afatshkurtra (si overdraft, kartë krediti etj), kanë rezultuar në rënie (respektivisht me 1 pp dhe 2 pp) në terma gjashtëmujorë dhe në rënie (respektivisht me 3 pp dhe 5 pp) në terma vjetorë.


Grafik 2.6 - Huamarrja sipas mënyrave të pagesës
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket ngarkesës së huasë ndaj të ardhurave të familjeve huamarrëse, rezultojnë se rreth 70% e tyre deklarojnë që kjo pagesë zë më pak se 30% të të ardhurave mujore ('deri në 10% të të ardhurave' për 29% të familjeve huamarrëse, "10-30% të të ardhurave" për 41% të familjeve huamarrëse) dhe kjo peshë ka rënë me 2 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 1 pp në terma vjetorë. Nga ana tjetër, rreth 30% të familjeve deklarojnë se kjo pagesë e tejkalon 30% të të ardhurave ("31-50% të të ardhurave" për 21% të familjeve, "51-70" për 7% të familjeve dhe "mbi 70%" për 3% të familjeve) (Grafik 2.9).

Grafik 2.7 - Huamarrja sipas raportit "kësti huasë/të ardhurat totale mujore"
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.6-Afati i mbetur deri në maturim

Në 58% të rasteve të huamarrjes deklarohet se huaja maturohet "brenda një viti" dhe kjo peshë ka rënë me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 18 pp krahasuar me një vit më parë; në 37% të rasteve, afati i mbetur është "1-5 vjet" (në rritje me 5 pp dhe 12pp krahasuar respektivisht me 6MII 2022 dhe me 6MI 2022) dhe në 5% të rasteve ka rezultuar "mbi 5 vjet" (e pandryshuar krahasuar me 6MII 2022 dhe në rritje me 1 pp krahasuar me një vit më parë). Rritja e rasteve të kredive me afat maturimi mbi 12 muaj, shkon në linjë me rritjen e huamarrjes nga sektori bankar kundrejt huamarrjes nga burime joformale.

Grafik 2.8- Huamarrja sipas maturimit të mbetur të huasë
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.7-Garantimi i huamarrjes. Në 72% të rasteve të huamarrjes rezultojnë se huaja është "e pa garantuar" dhe kjo peshë është rritur me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 1 pp krahasuar me një vit më

parë. Nga ana tjetër, pesha e rasteve të huamarrjes së garantuar 'me një pronë të familjes' ka rezultuar në rënie si krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë (respektivisht me 4 pp dhe 2 pp).

Grafik 2.9 Huamarrja sipas formave të garantimit të huasë
(në % ndaj totali të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zëri "tjetër" përmbledh rastet e huamarrjes së garantuar me forma të tjera, ku më shpesh përmendet garantimi i huasë përmes pagës, garantimi me një mall (si makina) etj.

3- Ngarkesa në borxh e familjeve

Në këtë seksion pyetjesh, familjeve huamarrëse u kërkohet të japin informacion vetëm për *huasë më të madhe* ekzistuese dhe që rëndon më shumë mbi ekonominë e familjes. Si rrjedhojë, peshat e përgjigjeve janë llogaritur mbi totalin e familjeve huamarrëse të përgjigjura për secilën pyetje.

3.1-Ndryshimi i këstit. Rreth 65% e familjeve huamarrëse të përgjigjura kanë deklaruar se kësti i huasë (ose huasë më të madhe në rast se kanë më shumë se një) ka mbetur i pandryshuar gjatë gjashtëmujorit referues, por kjo peshë ka rënë me 7 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 11 pp në terma vjetorë. Nga ana tjetër, numri i familjeve që kanë deklaruar 'rritje të këstit' ka tejkaluar numrin e atyre që kanë deklaruar 'rënie të tij'. Kjo ka rezultuar në një *balancë neto* të përgjigjeve prej +5.5 pp, në rritje si krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe një vit më parë.

Grafik 3.1 Ndryshimi i këstit mujor të huasë në 6 muajt e kaluar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2-Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar dhe pritshmëritë për 6 muajt e ardhshëm. Rreth 45% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese “*nuk ka ndryshuar*” gjatë periudhës së vrojtuar, por kjo peshë ka rënë me 2 pp krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës dhe me 6 pp krahasuar me një vit më parë. Pjesa tjetër e të përgjigjurve, vlerësojnë në agregat *përkeqësim të aftësisë së tyre paguese* (ku 47% kanë deklaruar “përkeqësim” dhe 8% kanë deklaruar “përmirësim”), duke rezultuar në një balance neto prej -39.4 pp. Gjithsesi kjo balancë sugjeron përmirësim krahasuar me rezultatin në periudhën paraardhëse (Grafik 3.2).

Grafik 3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.3 Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm



Ky perceptim është reflektuar dhe në përmirësimin e pritjeve të familjeve lidhur me aftësinë e tyre paguese në gjysmën e dytë të vitit 2023. Kështu, rreth 63% e familjeve huamarrëse *nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese gjatë gjashtëmujorit të dytë 2023*, ndërsa balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar -7.8 pp, duke sugjeruar një zbutje të pesimizmit që karakterizoi rezultatet e vrojtimit të kaluar (6MII 2022) (Grafik 3.3).

3.3-Pritshmëritë mbi marrjen e një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm⁸. Rreth 59% e të përgjigjurve kanë deklaruar se “*nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm*”, ndërsa rreth 41% e tyre (ose 430 familje), deklarojnë se e konsiderojnë mundësinë (në shkallë të ndryshme sigurie⁹) për të marrë/rimarrë një hua të re. Përsa a familjeve që e konsiderojnë marrjen e një huaje, ka rënë me 3 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 6 pp krahasuar me një vit më parë dhe kjo prirje është vënë re në tre gjashtëmujorët e fundit. Duke analizuar vetëm grupin e familjeve që *planifikojnë të marrin një hua të re (430 familje)*, rezulton se rreth 57% e tyre janë “*huamarrës të rinj*”, (pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit) dhe kjo peshë është rritur në terma gjashtëmujorë (me 2 pp), por ka vijuar të bjerë në terma vjetorë (me 3 pp).


Si rezultat i shpërndarjeve të mësipërme, *indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re*¹⁰ ka rezultuar 0.177, duke vijuar në rënie si krahasuar me periudhën e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë. Kjo sinjalizon ngadalësimin e mëtejshëm të kërkesës së individëve për kredi dhe në gjysmën e dytë të vitit 2023.

⁸ Pyetja i drejtohet të gjithë kampionit prej 1205 familjesh dhe asaj i janë përgjigjur 1055 familje ose rreth 88% e totalit të kampionit.

⁹ Alternativat e dhëna janë: “ka pak mundësi”, “ka shumë mundësi” dhe “është e sigurt”.

¹⁰ Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e % së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientët përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në 4 nën-intervale me gjatësi të barabartë 0.33. Koeficientët për secilën alternativë rezultojnë: 0 (“nuk ka asnjë mundësi”), 0.33 (“ka pak mundësi”), 0.66 (“ka shumë mundësi”) dhe 1 (“është e sigurt”). Indeksi i përfutur merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.

Grafik 3.4 Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm dhe indeksi i planifikimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4- Pasuria e familjeve


Kjo rubrikë përmban vetëm 2 pyetje mbi pronat e patundshme dhe pasurinë financiare të familjeve të intervistuar dhe i drejtohet të gjithë kampionit të familjeve. Rezultatet për 6-mujorin e parë të vitit 2023, paraqiten si më poshtë:

4.1-Pasuritë e patundshme të familjeve. Për këtë seksion pyetjesh kanë dhënë përgjigje 999 familje, nga të cilat 95% kanë deklaruar se zotërojnë të paktën një pronë të patundshme dhe kjo peshë është rritur me 1 pp respektivisht krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe ka mbetur e pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Familjet e përgjigjura deklarojnë se zotërojnë në total *1485 prona të patundshme të llojeve të ndryshme* ku: 92% e tyre (969 familje) zotërojnë *“1-2 prona të patundshme”* kryesisht të llojit *“shtëpi banimi”* ose kombinim i një shtëpie banimi dhe një prone tjetër si *“tokë”, “dyqan”, “godinë”* etj. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe ka rënë me 1 pp krahasuar me një vit më parë (Grafik 4.1). Nga ana tjetër, 3% deklarojnë se zotërojnë *“më shumë se 2 prona të patundshme”*, (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.), ndërsa 5% kanë deklaruar se *“nuk zotërojnë asnjë pronë”*.


Duke e fokusuar analizën vetëm në grupin e **familjeve huamarrëse** (256 familje), rezulton se këto familje deklarojnë gjithsej 357 prona të patundshme, ku 68% e tyre janë *“shtëpi”*, 29% janë *“toka”* dhe pjesa tjetër janë *“dyqane”* dhe *“godina”* dhe lloje të tjera pronash.

Në shpërndarjen e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë, rezulton se: rreth 93% e tyre (239 familje) zotërojnë *“1-2 prona të patundshme”* në momentin e intervistimit, dhe kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me vërtetimin e kaluar dhe është rritur me 1 pp krahasuar me një vit më parë. Në shumicën e rasteve këto prona janë një shtëpi banimi ose kombinimi i një shtëpie dhe një sipërfaqe toke. Vetëm 1% e familjeve huamarrëse (2 familje) deklarojnë se zotërojnë *“më shumë se dy prona”* ndërkohë që rreth 6% e familjeve huamarrëse (15 familje) kanë deklaruar se *“nuk zotërojnë asnjë pronë”* (Grafik 4.2).

Grafik 4.1 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)



Grafik 4.2 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)




Burimi: Banka e Shqipërisë.


4.2-Pasuritë financiare të familjeve¹¹. Nga përgjigjet e dhëna lidhur me zotërimin e pasurive financiare nga familjet, rezulton se për periudhën e vrojtuar, 55% e totalit të kampionit (familje huamarrëse dhe johuamarrëse) dhe 75% e grupit të familjeve huamarrëse, “nuk zotërojnë asnjë lloj pasurie financiare”. Të dyja këto pesha janë rritur krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.

Duke analizuar vetëm pjesën e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare të formave të ndryshme (përfshirë rastet që “nuk kanë asnjë lloj pasurie financiare”), rezulton se “depozitat dhe/ose llogaritë bankare” vijojnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të kampionit të familjeve (51% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (50% e rasteve të raportuara). Gjatë periudhës së vrojtuar, këto pesha kanë rënë, respektivisht me 20 pp për totalin e kampionit, dhe me 29 pp në rastin e familjeve huamarrëse.

Grafik 4.3 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)



Grafik 4.4 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹¹ Pyetjes mbi pasuritë financiare në pronësi të familjeve të intervistuar i janë përgjigjur 1088 familje.

Përdorimi i formave të tjera të investimit, të përmbledhura në zërin '*investime të tjera*'¹², ka rezultuar në rritje me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar në rastin e totalit të kampionit të vrojtuar, dhe në rënie me 1 pp në rastin e grupit të familjeve huamarrëse.

¹² Në zërin "Investime të tjera" përmbliidhen rastet e investimeve në: bono thesari, sigurim jete, fond pensioni privat dhe aksione.